

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1899-4/2016 të datës 06.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuarit dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës Jur. Dip B. P. nga Prizreni, me datë 20.09.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**B. B.** nga i ati A. dhe e ëma S. e lindur G., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme të tregtisë, përkthyes, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 23.02.2016, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në Prizren rrugën..., me qëllim që t’ sjell vetit pasuri të kundërligjshme si shfrytëzues i shërbimeve komunale, përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar në mënyrë që e shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor i cili në brendi për rreth qelqit nga ana e majtë ka futur shiritin filmit kështu është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material.

#### **Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

### DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari obligohet në emër të dëmit të shkaktuar, të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren, të paguaj shumën në lartësi prej 63.34 €, pesëmbëdhjetë ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1899-4/2016 të datës 06.10.2016, kundër të akuzuarit B. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 23.02.2016, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në Prizren rrugën ..., i akuzuari B. B. me shifër të konsumatorit 151913 me numër të njehsorit elektrik 17741017, pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se i akuzuari përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, e shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor i cili në brendi për rreth qelqit nga ana e majtë ka futur shiritin filmit kështu është penguar puna e diskut, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë

zhvillimit të procedurës, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi kompenzimin e dëmit të dëmtuarit, është marrë në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.2138/2016 të datës 20.09.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.